**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**Komuna e Drenasit**
**Kuvendi i Komunës**

**Nr.** 02.060.48842 **dt.** 21.09 **2022**

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Gllogocit), nenit 3 pika 3.7 si dhe nenit 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Milaim Hajdari, më datë: **27.09.2022** (E Marte ) duke filluar në ora **10:00** në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KK i mbajtur më dt. 31. 08.2022.
2. Raporti i degjimeve publike për listen e projekteve kapitale për buxhetin e vitit 2023 dhe projeksioneve për vitet 2024-2025.
3. Propozim Vendim i Buxhetit të Komunës së Drenasit për vitin 2023-2025.
4. Propozim vendim për formimin e Komisionit të ankesave i cili do të shqyrtoj ankesat e palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës.
5. Propozim vendim për formimin e komisionit komunal të aksionereve për NPL Stacioni i Autobusëve SH.A – Gllogoc.
6. Propozim vendim- Me ketë propozim vendim kërkohet që automjetet zyrtare të QKMF "Dr. Hafir Shala" Drenas, si dhe automjetet e Qendrës për punë sociale- Drenas, të kalojnë në pronësi të Komunës së Drenasit.
7. Raporti i progresit për Implementimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2021.
8. Raport nga menagjerët e dy Kompanive KRU-„Ujësjellsi'', dhe KRM- „Pastrimi'' njesia Drenas
9. Të ndryshme.

Drenas, 21.09.2022

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Milaim Hajdari

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY
Pranuar 21 09 22
Nj. Org 02 Numër 060. Shtojca 48842 Vlera

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**Komuna e Drenasit**
**Zyra e Kuvendit**

**Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 21. 09.2022, si vijon:**

-Pasi kryesuesi përshëndeti të pranishmit njoftoi anëtarët e K. P. F-ca, për rendin e ditës, ku i pyeti të pranishmit nëse ka dikush debat rreth pikave të rendit të ditës, mundet me marr fjalën, diskutime nuk pati hedhi në votim rendin e ditës.

- **Votuan 07 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i KPF – ca Drenas të dt. 24.08.2022.
   - **Votuan 07 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**
2. Raporti i degjimeve publike për listen e projekteve kapitale për buxhetin e vitit 2023 dhe projeksioneve për vitet 2024-2025.
   - **Rekomandohet për Kuvend.**
3. Propozim Vendim i Buxhetit të Komunës së Drenasit për vitin 2023-2025.
   - **Votuan 06 Për, Kundër: 01, dhe Abstenim: 00**
4. Propozim vendim për formimin e Komisionit të ankesave i cili do të shqyrtoj ankesat e palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës.
   - **Votuan 07 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**
5. Propozim vendim për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për NPL Stacioni i Autobusëve SH.A – Gllogoc.
   - **Votuan 07 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**
6. Propozim vendim- Me ketë propozim vendim kërkohet që automjetet zyrtare të QKMF "Dr. Hafir Shala" Drenas, si dhe automjetet e Qendrës për punë sociale-Drenas, të kalojnë në pronësi të Komunës së Drenasit.
   - **Votuan 07 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00**
7. Raporti i progresit për Implementimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2021 .
   - **Rekomandohet për Kuvend.**
8. Të ndryshme.

Kryetari Ramiz Lladrovci mori fjalën rreth dy kompanive të KRU- ,,Ujësjellësi'' dhe KRM -,,Pastrimi" me njësi në Drenas. Ku propozoi si pikë shtesë për mbledhje të KK të dt. 27.09.2022, të jetë:

- Raport nga menagjerët e dy Kompanive KRU-,,Ujësjellësi'', dhe KRM- ,,Pastrimi'' njësia Drenas

**Pasi nuk pati diskutime tjera mbledhja përfundoi në ora 10: 45.**

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Milaim Hajdari**

Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës

Nr. 02-060-48858 dt. 21.09 2022

**PROCESVERBALI**

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: **31.08.2022**

**Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 29 anëtarë:** Labinot Halilaj, Bekim Lestrani, Arigon Sinani, Zeqir Hasi, **Laurita Muhadri Bujupi,** Hamit Kastrati, **Blerina Gashi,** Gani Krasniqi, Fatmir Baliu, Qendrim Mulaj, **Malsore Cakiqi, Agnesë Kastrati, Albulena Saliuku,** Sali Dvorani, Mergim Pirraku, Mehedin Salihu, Hamit Haxhiu, Jahir Hajdari, **Azemine Bujupi-Gjoka, Marigona Bazaj, Mirlinda Dvorani, Florentina Elezi-Veliu, Filloreta Bujupi,** Drin Halilaj, Muhamet Kurtaj, **Egzona Terrdevci,** Arber Halilaj, **Valentina Leku,** Beqir Kiqina, Egzon Qorri. Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, Drejtor të drejtorive komunale. Mungoi Muhamet Kurtaj.

**Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal-Milaim Hajdari,**

Kuvendi filloi punimet më këtë :

**Rend dite:**

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KK i mbajtur më dt. 27.07.2022.
2. Propozim Vendim i Buxhetit të Komunës së Drenasit për vitin 2023-2025.
3. Propozim Vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.
4. Propozim Vendim për fillimin e Hartimit të Planit Rregullues të hollësishëm për qendrën e Qytetit Gllogoc.
5. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së Klub Fitness Koca.
6. Propozim Vendim për financimin e Projektit Volejbolli për Femra të OJQ-së KV Gryka .
7. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së „KF FORTUNA"
8. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së Klubi i Boksit Drenas
9. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së Klubi Publik i Futbollit Drenas
10. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së FC LIQENI Drenas
11. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së Klubi i Volejbollit Feronikeli **Meshkujt** Drenas
12. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së Klubi i Volejbollit Feronikeli **Femrat** Drenas

13. Propozim Vendim për financimin e Projektit botim i Librit monografi RFBSH Nezir Prokshi Drenas.
14. Propozim Vendim për formimin e Komisionit për plotësim ndryshimin e Rregullores për Taksa Tarifa Ngastra dhe Gjoba.
15. Njoftim rreth shkëputjes së Kontratës së shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të Komunës së Drenasit.
16. Propozim Vendim për bartjen e mjeteve Financiare nga Kategoria Rezervë.
17. Raporti i punës Janar-Qershor 2022 i Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale.
18. Të ndryshme.

Të mërkurën me dt.31.08.2022 është mbajtur mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Drenasit, ku për diskutim ishin 19 pika për rend dite.

Më poshtë ju elaborojmë pikat që janë diskutuar e miratuar me shumicë votash në mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës;

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari-** pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit njoftoi me rendin e ditës anëtaret e Kuvendit Komunal dhe konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes theksoi se kemi edhe një pikë shtesë për rendin e ditës: **Propozim Vendim për shfuqizimin e Vendimit Nr. 02-030/01-24082, të dt. 30.05.2022.**

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim rendin të ditës, me piken shtesë të cekur me lartë, prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, **(Për)** votuan 29 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati. U miratua rendi i ditës me vota unanime.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: 1. **Procesverbali i mbledhjes të Kuvendit Komunal të dt. 27.07.2022.**

**Arbër Halilaj,** sa i përket procesverbalit propozoj që të behët një sistem tek pjesëmarrja e anëtareve të kuvendit të shkruhet me emër, mbiemër, subjekt politik të shkruhet ai që mungon, pastaj drejtoret që kanë qenë prezent, mysafir, dhe të konstatohet kuorumi.

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, **(Për)** votuan 29 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati. Miratohet procesverbali i mbledhjes se rregullt i mbajtur me dt. 27.07.2022.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Propozim Vendim i Buxhetit të Komunës së Drenasit për vitin 2023-2025.**

**Egzona Tërdevci,** Propozim Vendim i Buxhetit të Komunës së Drenasit për vitin 2023-2025, ky buxhet nuk i përmbush nevojat dhe kërkesat primare të qytetareve të komunës tonë, grumbullimi i projekteve në formën siç është paraqitur e bënë të vështir me kuptu se cilat projekte dhe çfarë gjatësie do të shtrohet rruga apo kanalizim, sikur të kishim sqarime për projektet do ta kishim edhe ne me të lehtë me definua se si është bërë orientimi i mjeteve, po ashtu kërkoj disa sqarime tek lista e projekteve kapitale në kornizën afatmesme buxhetore që e kemi miratuar në qershor janë të ndara 400 mijë euro të kodi 611/650 apo drejtoria për kadastër përkatësisht tek nen programi 610-shpronesim, listën e projekteve kapitale që e kemi para vetes në ketë propozim nuk ka asnjë mjet të ndarë në ketë kategori kërkoj sqarim për ketë pjesë. Po ashtu është bërë edhe një ndryshim tjetër tek lista e projekteve kapitale që e

kemi miratua në kornizë afatmesme buxhetore në qershor përkatësisht është bërë zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit "Xhevë e Fehmi Lladrovci" kornizën afatmesme të miratuar në qershor për ketë projekt kanë qenë në planifikuara 400 mijë euro në propozimin për buxhet tani janë të planifikuara 5546 € kërkoj sqarim edhe për ketë? Kur flasim për prioritetet nisur nga vizita në teren raporti i dëgjimeve buxhetore por edhe i takimeve që i kemi vazhdimisht me qytetar prioritet mbetet furnizimi me ujë të pijes, shihet në propozimin që e keni bërë në buxhetin për vitin 2023 të destinuara për ujë të pijes janë vetëm 270 mijë euro përkatësisht projekti i ndërtimit kapaciteti të ujit ne komunën e Drenasit për vitin 2023, duke e dikur faktin që shumë vendbanime janë pa ujë të pijes sa mendoni që kjo shumë e ndarë do t'i plotësoj këtë nevoje bazike te qytetare tanë dhe a ka pas mundësi me nda me shume mjete për këtë qellim, Ndriçimi publik ka qene kërkesë drejtuar jush ne secilin lokalitet qe janë mbajtur dëgjime buxhetore ju i nderuar z.Lladrovci keni bere zotim edhe ne fushate po edhe ne diskutime publike qe ndriçimi publik do te përfundoj brenda vitit qe jemi, si dhe a do te përfundoj ndriçimi publik brenda vitit që jemi aktualisht?
Po ashtu me sa kom pa ne propozim buxhet për vitin 2023 nuk ka mjete te destinuara për parking, kur planifikohet të rregullohet ky problem?

**Drin Halilaj**-gjatë diskutimeve publike bugjetore nga banoret e fshatit Tërdevc edhe përmende që ne shkollën e fshatit uji është i pa pijshëm e keni sugjeru hapjen e një pusi a mund të na përgjigjeni që hapja e këtij pusi është e mundur këtë vit apo në vitin tjetër?

**Arbër Halilaj**- nuk shoh specifikim të një projekti të caktuar a Kodi 451 psh. infrastruktura në Fshatin Arbri e Epërme 70 mije euro rehabilitimi si dhe nuk e kam vërejte që janë nga mjete për kompaninë publike të cilën kemi votuar të themelohet.

**Kryetari i Komunws Ramiz Lladrovci** –ne nuk jemi duke biseduar për buxhetin e këtij viti sepse është miratu, janë projekte tu u zhvillu, jo vetëm qe oshte zotim po është ne një far mënyre edhe para masë parashikim i buxhetit i cili do te zhvillohet këtë vite ,qdo lagje ku ka shtylla te betonit te rrjetit te ri do ta vendosim ndriçimin këtë vit proceduarat janë zvarrite pak për shkak te krizës globale te çmimeve, për parking besoj qe shume shpejte ka bere një projekte ne kuadër te rregullimit te sheshit dhe parkingjeve ne komunën e Drenasit, ndoshta mundemi me fillu edhe këtë vit po vitet 2024,2025,e po shpresoj edhe buxhetin qe do ta kemi nga grandi i performances do te na ndihmoje shume, Z. Halilaj pusin tashme e kemi hap ne shkollën ne Tërdevci ,edhe te buxheti te ajo qe e kemi hjek prej drejtorisë se gjeodezisë kemi kërkesë prej thesarit edhe ne e kemi dergu ne kod investime kapitale një investim qe e kemi te madh kane than qe kanë me i pagu qeveria na kam udhezu me i deru ne investime kapitale, ju lutem kur flasim për 2023 flasim vetëm për 2023 qka kemi me ba si vjetju kisha lut mbani takime me qytetar dhe ftoni zyrtar tanë te mbajnë raport,

**Drejtori i Financave Shyqyri Bublaku**-sa i përket buxhetit për shpronësime i cila ka qene si kategori e veçantë ne investimet kapitale ne vitet e kalume ne baze te planit kontabël te Ministrisë se Financave parashihet qe shpronësime nuk është investim kapital dhe nuk mund te kaloje ne kategori tjetër çdo shpronësim qe behet për një projekt për me hy ne kosto te projektit kapital,sa i përket specifikime ne i kemi 80 projekte secilën prej tyre me specifiku duhet konkurset me shpall për me i plotësua te gjitha ato pe rate shkak nuk është bere specifikimi i tyre

**Florentina Elezi Veliu** –vetëm deshta me u lidh te ajo qe po thoni qe s'kemi mundësi mi hap shume tenderë për secilin lagje i kemi jep si ide edhe vitin e kalum qe me pas enje plan te mbrendshem qe te paktën qe ne asamblistët me dite sakte ne qfare do fshati sa metra asfalte është apo kanalizim,sirpo nje plan i brendshëm mundet me u be përndryshe nëse veq i shtim dy fshatra me një projekt ne nuk dimë për secilin fshat qka ka me ndodh një plan i brendshëm mundet me u be?

**Egzona Terdevci** –te pjesa e projektit zgjerimit dhe ndërtimi i sheshit "Xheve dhe Fehmi Lladrovci qe ka ndryshu shuma nëse ka mundësi një sqarim është rrit shuma 105 mije e 446 euro, Faleminderit

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci**–znj. Elezi ju jeni asamblistë disa mandate e dini qe prej 300 tenderëve ne i kemi zbrit ne 80 besoj kemi me zbrit ne 40 se nuk kemi mujt me qele tender për 300 metra ni lagje megjithatë tash po përfundon asfaltimi ne çdo lagje te fshatrave tone,5 mije a ka ardh si rezultat i kërkesës se thesarit qe na ka dergu qe nuk ka shpronësime me sepse hin shpronësimet ne kuadër te projekteve qe do ti zhvillojmë ne kemi kaluar një pjese te atyre 400 mije eurove i kemi kalu te sheshi qe presim qe sheshi te na kushtojnë me shume se sa qe e kemi ne planifikim, Faleminderit!

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, **(Për)** votuan 29 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: 3. **Propozim Vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.**

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari,** theksoj se dy anëtar duhet të jenë nga kuvendit, dy nga ekzekutivi dhe një nga shoqërisë civile.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci,** për anëtar nga ekzekutivi propozoj Flutura Avdiu dhe Enver Hoxha ndërsa nga shoqëria civile Arben Koliqi.

**Bekim Lestrani**- ne si grup i parlamentar PDK për anëtar të komisionit nga kuvendi propozojmë- Qëndrim Mulaj,

**Hamit Haxhiu**- ne si grup i parlamentar Demokratet për Drenasin propozojmë Dr.Salih Dvorani.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari**- e hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, **(Për)** votuan 30 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati. Miratohet pika e tretë e rendit të ditës me këtë përbërje të komisionit:
Flutura Avdiu- Anëtare nga ekzekutivi.
Enver Hoxha- Anëtar nga ekzekutivi.
Qëndrim Mulaj- Anëtar nga kuvendi.
Salih Dvorani- Anëtar nga kuvendi.
Arben Koliqi- Anëtar nga Shoqëria Civile.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës: **4. Propozim Vendim për fillimin e Hartimit të Planit Rregullues të hollësishëm për qendrën e Qytetit Gllogoc.**

**Beqir Kiqina** –sa i përket propozim vendimit për fillimin e hartimit te planit rregullues te hollësishëm ne qendrën e qytetit kish dashtë një sqarim te shkurtër a ndërlidhet pasi qe ne seancat e kalume është hartua harta zonale dhe sa lidhet ky propozim vendim ky projekt me qendrën e qytetit dhe a bjen ndesh me hartën zonale sepse ktu ndërlidhet dhe janë qeshje me te hollësishme,dhe a ka propozu MPL qe te propozohet një propozim i tille apo komuna do te ja propozoj Kuvendit me pastaj MPL varet si do te gërshetohet me hartën zonale,Faleminderi!

**Drejtoreshë e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit Flutura Avdiu** –përshëndetje te pranishëm ,si qe është e cekur edhe ne arsyetimin e këtij propozim vendimi ne seancën e kaluar kemi miratuar hartën zonale te Komunës për periudhën 2022-2030 harta zonale i ka identifikuar zonat për te cilat kërkohet plani rregullues i hollësishëm plani rregullues do te fillohet ne qendrën e qytetit e cila është ne sipërfaqe prej 110 H kryesisht fillimi i hartimit te planit rregullues te hollësishëm behet nga harta zonale nuk bien ndesh përkundrazi d.m.th. planifikim hapësinor i cili parashihet ne harte Zonale kjo është me detaisht nuk ka probleme gjate fillimit te ndërtimit dhe kemi obligim ligjor ne mënyrë qe te përmbushët planifikim hapësinor plani i qytetit duhet te filloj te hartohet ne mënyrë qe te plotësohet komplet legjislacioni dhe ky plan derivon nga plani zhvillimor Komunal dhe nga harta zonale e komunës behet ne pajtim te plote me këto dy dokumente te planifikim hapësinor pasi te miratohet legjislacioni i planit hapësinor dhe udhëzimi administrativ për elementet kërkesat themelore për hartimin zbatimin dhe monitorim e planeve rregulluese te hollësishme parasheh qe duhet te fillohet për hartim te planit te hollësishëm me vendim te Kuvendit me pastaj te filloje kompania projektuese te cilën e kemi kontaktuar përmes prokurimit publik ne kontrate kornizë 3 vjetarë te filloj me hartimin e këtij plani, fillimisht duhet te filloj ne qendër te Drenasit ne zonën urbane ka me se shumti nevoje

**Egzona Tërdevci**-nëse mundesh vetëm afatin kohore se kur mundet me u përfundua kjo ?

**Drejtoreshë e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit Flutura Avdiu** afati kohor edhe pse kemi lidhur kontratën kornize për 3 vite kemi ndare detyrat projektuese fillimit duhet te fillohet me qendrën e qytetit pastaj do te fillohet me qendrën e komoranit vitin tjetër dhe me zonat tjera te cila ka nevoje për plan te detaizuar ,kompania vetëm do te filloje punën tashme pasi ta pranojmë draftin fillestar do ta qesim ne shqyrtim publik 30 dite do te pranojmë komentet dhe sugjerimet do te bëjmë vlerësimin strategjik mjedisor te këtij drafti te planit rregullues te hollësishëm pasi ta marrin pëlqimin për vlerësim nga MPHHI ather do te procedohet menjëherë drafti përfundimtar, po besoj qe deri ne fund te vitit do ta sjellim ne kuvend propozimin vendim për miratim te vendimit

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi e hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar dhe votuan me: 30 vota **(Për),** kundër nuk pati, Abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së Klub Fitness Koca.**

**Arbër Halilaj** – pavarësisht jam gjithmonë qe te subvencionohet sporti, kultura sepse paraqesin ushqim shpirtëror për qytetaret e Drenasit si dhe ne vazhdimësi kane qen këto klube këta sportist dhe suksese e tyre natyrisht janë edhe sukses tona edhe na bëjnë krenare ,këtu po flitet për projekte ndërsa ne sot nuk kemi asnjë prej tyre prej 5 deri ne 13 qka parasheh aj projekt qka parasheh cilat janë shpenzimet cilat janë synimet e atij projekti qka dëshiron te arrij aj klub, kemi paske synime edhe ne te kalumën klubi Fortuna është k lum me te cilin po furnizohet tash Feronikeli e ndjej obligim prej njerëzve te gjalle e te vdekur qe kane kontribu për atë klub a ka dikush me dhanë informate pse erdh deri te shuarja e klubit, pse po ndërpritet një historik duhet dikush te japë llogari pse ka ardh deri këtu, tash janë obligimet si falimentoj një kompani si ni klub nuk mundet me hi kerkush ato mbesin si obligime edhe rregulla te UEFA dhe FIFA, klubi i ri i Fernonikelit me një kryetar i cili sa kame informata punon edhe ne kuvendin komunal ka te beje me portalin Drenica online tash kryetar i klubit nuk e di a është konflikt interesi kërkoj sqarime nga Kryetari, parimisht jam qe secilin nga këto projekte pasi te na prezantohet se qka janë planifiku ti votojmë një nga një ,kisha kerku sqarim te veçante për falimentimin e klubit dhe fuzionimin me klubin e futbollit Fortuna,Faleminderit

**Florentina Elezi-Veliu,** une vetëm deshta me cek në Komitet për Politikë e Financa kemi kërku që me i sjellë projektet qe me dit secili klub ku është si e ka situatën qe ne me pas me te lehte ne si asamblistë qe me votu për apo kundër, aty drejtoresha u pajtu tha qe ekzistojnë projektet dhe qe i sjellim sot nuk kemi asnjë material shtese kisha kërku qe herave tjera me u respektu pak ma shume Komiteti per politike e financa edhe rekomandimet qe i jepum

**Hamit Haxhiu**-një sqarim feronikeli u fuzionu ne Fortuna kjo e ka ndru emrin ne Fortuna 74,Fortuna ka kriju klub te ri mjetet te cilat dedikohen masi nuk e kem te qarte pe shkak te procesit kujt i shkojnë këto mjete Furtunës apo Feronikeli 74.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci,** -Arbër qaj biznesmeni na ka bere krenare dy here kampion Kosovë dy here ne gara ndërkombëtare, dy here kupën e Kosovës dhe dy here super kupën e Kosovës, e kemi spjegu pandemia i ka dëmtu shume klubet me te mëdha te botes pra na ka dëmtu edhe neve ne po vazhdojmë me emër me klub te cilin e kemi sipas ligjit edhe sipas ligjeve te UEFAS,kemi pas mundësi me be me i eliminua borgjet e mëdha qe kane mbete ne klub 800 mije euro ose me shu krejt ,pra i kemi humb do triumfe
Kryetari qe përmende qe është zyrtar nuk ka asnjë përgjegjësi ligjore ne ketë drejtim nuk merr asnjë vendim dhe nuk ka asnjë ndikim ne kuadër te komunës me subvencionet qe i ndahen ,znj.Elezi ju e dini qe projektet nuk i kemi sjell as herëve te tjera ne ketë Kuvend sepse kane te dhëna siç janë nr.leternjoftimit, kontot por një komision profesional qe e ka vlerësu edhe e ka përcaktua kujt mi nda edhe kujt jo subvencione, kujt intereson me shume me dite mundet me shkume pa ne mënyrë fizike ,

**Drejtoresha për Kulturë Rini dhe Sport, Laureta Thaqi**- megjithëse disa pergj i dha edhe kryetari po ju informoje edhe raport për mbledhje lidhur me subvencionim e klubeve duke u bazuar ne thirrjen publike te shpallur nga drejtoria për kulturë rini dhe sport, në baze te rregullores edhet hapur thirrja publike e cila ka qëndruar ne faqe ku kane pasur te drejte te aplikojnë individ te komunës se Drenasit dhe OJQ ne komunën e Drenasit brenda kësaj kohe është formuar edhe komisioni i cili ka qene i pavarur dhe tërësisht profesional dhe i cili ka vlerësuar te gjitha kërkesat qe kane ardhur ne drejtorin tone te paraqitura qofte nga klubet apo edhe nga individët për mbështetej financiare për projektet te cilat i kane paraqite, varësisht prej projekteve duke u bazuar ne rregullore qe i përmenda është bere vlerësimi sipas projekteve ,ne i kem i te gjitha pika e renditura ato te cilat kane qene deri ne 1000 mije euro

ato nuk kalojnë ne kuvendin komunal mirëpo vetëm subvencionohen ne baze te kërkesave te komisionit ndërsa këto kalojnë përmes kuvendit, pika 5 qe ka qene propozim vendimi për financim e projektit Fitnes Koca klubi ne fjalë ka kërkuar mbështetje financiare lidhur me mbulimin e shpenzimeve për pjesëmarrje ne gara te cilat organizohen brenda dhe jashtë vendit, avancimin e mëtutjeshëm përfaqësimin e Drenasit ne gara ne këtë fushe te sportit ,pastaj propozim vendimi i klubit te volejbollit për femra KF Gryka duke u bazuar ne rregulloret qe përmenda me pare kërkohet mbështetja financiare për projektin e KF Gryka lidhur me mbulimin e shpenzimeve për projektin avancimi dhe motivimi i volejbollit për femra synimi i këtij projekti është mbështetja e klubit për femra ne volejboll për avancimin dhe motivimin e këtij sporti edhe me tutje duke siguruar pjesëmarrje edhe me tutje ne loje kampionale ,ushqim, pije, stërvitje, si dhe veshmbathje dhe paisje te tjera qe janë te nevojshme ne ketë klub ne mënyrë qe te vazhdoje garat dhe përfaqësimet e ndryshme sipas federatës se sportit Pika 7 e rendit te ditës propozim vendimi për financimin e projektit te KF. Fortuna përmes këtij propozimi kërkojmë mbështetje financiare lidhur me mbulimin s shpenzimeve për aktivitet sportive kërkesa e tre është vlerësuar për mbështetje pasi qe klubi ka paraqitur arsyeshmërin ne disa elemente si shpenzimet e pagave për lojtare, paisje sportive ,pre kontrolle mjekësore te lojtareve për transferim te lojtareve mbështetje për klubin ne mënyrë qe te siguroj pjesëmarrje ne gara te ndryshme
Propozim vendimi për financim e projektit Klubi Boksit Drenas përmes këtij propozim vendimi kërkohet mbështetja financiare për ketë projekt i cili sipas komisionit vlerësuese edhe vlerësuar me shumen 2mije euro financimi do te behet nga kategoria e subvencioneve klubi ka kërkuar mbështetje per projektin zhvillimi i aktiviteteve sportive ne boks pjesëmarrje ne turne te organizuara nga federata e boksit ne Kosovë, ky projekt do te përfshin te gjitha kategoritë si pioner,kaget,junior
Propozim vendimi për financimin e projektit Klubi publik i futbollit Drenas me ketë kërkohet mbështetja financiare lidhur me mbulimin e shpenzimeve për aktivitet sportive te këtij klubi ne përfaqësim e Drenasit ne gara shpenzime qe ju nevojiten klubit
Propozim vendimi për financimin KF liqeni Drenas me ketë propozim vendim kërkohet mbështetja financiarë për mbulimin e aktiviteteve sportive, për sigurim e pagave, ushqim etj ku dihet qe edhe kyn klub është shpallur kampion ne nivel vendi
Si dhe po merr pjese ne shume gara edhe jashtë vendit .
Propozim vendimi pe financimin e projektit klubi fe nikelit meshkujt te dy kategoritë meshkuj dhe femra kane kërkuar mbështetje zhvillim e sportisteve ne fushat e volejbollit përgatitje për gara kombëtare ngritje nivelit garues.
Propozim vendimit për financimin Vezir Prokshi ku kërkohet financimi botim libri i monografisë për revistën shqiptare ku përfshinë vitet 2006,2014,dhe historiku saj

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci,** –mjetet për Fortunen derdhen te Fortuna, Fortuna tashme është ne ligen e dyte te futbollit te Kosovës, Faleminderit!

**Muhedin Salihu**-ni përmendi këto klube edhe jam për mi financu mirëpo këtu nuk po ekziston klubi shahit nuk ka bere kërkese apo qka është ne pyetje

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci,** çdo klub qe e ka përzgjedh komisioni ne 1500euro ne i kemi bere vendimet edhe do te shkojnë direkt me nënshkrim temin ndërsa këto qe janë mbi 1500 euro duhet me kaluar neper kuvend.

**Albulena Saliuku** ,unë pajtohen plotësisht te financohen te gjitha projektet nga pika 5 deri ne 13 dhe te gjithë duhet ti përkrahim dhe ti votojmë këto propozime.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi e hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar dhe votuan me:
28 vota **(Për),** kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6.** Propozim Vendim për financimin e Projektit Volejbolli për Femra të OJQ së KV Gryka .
Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi e hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar dhe votuan me: 28 vota **(Për),** kundër nuk pati, Abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: 7. **Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së „KF FORTUNA"**
Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi e hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar dhe votuan me: 28 vota (Për), kundër nuk pati, Abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës. **8. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së Klubi i Boksit Drenas.**
Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi e hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar dhe votuan me: 28 vota (Për), kundër nuk pati, Abstenim nuk pati

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës. **9. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së Klubi Publik i Futbollit Drenas.**
Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi e hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar dhe votuan me: **24 vota (Për), 04 kundër,** Abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e dhjetë të rendit të ditës. **10. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së FC LIQENI Drenas.**
Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi e hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar dhe votuan me: 29 vota (Për), kundër nuk pati, Abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës. **11. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së Klubi i Volejbollit Feronikeli Meshkujt Drenas.**
Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi e hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar dhe votuan me: 29 vota (Për), kundër nuk pati, Abstenim nuk pati

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës.**12. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-së Klubi i Volejbollit Feronikeli Femrat Drenas.**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi e hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar dhe votuan me: 29 vota (Për), kundër nuk pati, Abstenim nuk pati

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës. **13. Propozim Vendim për financimin e Projektit botim i Librit monografi RFBSH Nezir Prokshi Drenas.**
Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi e hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar dhe votuan me: 29 vota (Për), kundër nuk pati, Abstenim nuk pati

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e katërmbëdhjetë të rendit të ditës: **14. Propozim Vendim për formimin e Komisionit për plotësim ndryshimin e Rregullores për Taksa Tarifa Ngastra dhe Gjoba.**

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci,** komisioni do të formohet nga 7 anëtare të komisionit tre nga ekzekutivi një OJQ dhe dy nga kuvendi, nga ekzekutivi propozojmë Violeta Baleci, Arianit Bala, Besart Bajrami, nga shoqëria publike Sulltane Mulaj.

**Bekim Lestrani,** propozoi për anëtar të komisionit nga kuvendi Valentina Leku.

**Hamit Haxhiu,** propozoi për anëtar të komisionit nga kuvendi Mehedin Salihu.

**Egzona Tërdeci,** propozoi për anëtar të komisionit nga kuvendi Drin Halilaj.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi e hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar dhe votuan: **30 vota (Për), Kundër nuk pati, Abstenim nuk pati.** Komisioni u formua me këtë përbërje të komisionit:
Violeta Baleci- Anëtare nga ekzekutivi.
Arianit Bala- Anëtar nga ekzekutivi.
Besart Bajrami- Anëtar nga ekzekutivi.
Valentina Leku-Anëtare nga Kuvendi.
Mehedin Salihu- Anëtar nga Kuvendi.
Drin Halilaj- Anëtar nga Kuvendi.
Sulltane Mulaj- Anëtare nga OJQ.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e pesëmbëdhjete të rendit të ditës: **15. Njoftim rreth shkëputjes së Kontratës së shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të Komunës së Drenasit.**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi e hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar dhe votuan me: **21 vota (Për), 09 vota Kundër, Abstenim nuk pati.**

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e gjashtëmbëdhjetë të rendit të ditës: **16. Propozim Vendim për bartjen e mjeteve Financiare nga Kategoria Rezervë.**
Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi e hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar dhe votuan me: **26 vota (Për), 04 vota Kundër, Abstenim nuk pati.**

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e shtatëmbëdhjetë të rendit të ditës: **17. Raporti i punës Janar-Qershor 2022 i Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale.**

Mcqë nuk pati diskutime kryesuesi hapi diskutimin për pikën e tetëmbëdhjetë të rendit të ditës: **18. Propozim Vendim për shfuqizimin e Vendimit Nr. 02-030/01-24082, të dt. 30.05.2022.**

**Egzona Tërdeci,** siç e kemi cek edhe ne se ky vendim është i paligjshëm ashtu edhe ministria e ka kthy përgjigjen.

**Mehedin Salihu,** vendimi i asamblesë ka qenë i arsyeshëm, unë bazohna në ato se çka e shohim.

**Labinot Halilaj,** mendoj se hapja e perspektives të pronave qoftë publike qofte private gjithmonë kur kanë qellim të mirë është në interes të zhvillimit të komunës.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi e hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar dhe votuan me: **21 vota (Për), 07 vota Kundër, Abstenim nuk pati, u shfuqizua vendimi Nr. 02-030/01-24082, të dt. 30.05.2022.**

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e nëntëmbëdhjetë të rendit të ditës: **19. Të ndryshme.**

**Filloreta Bujupi,** u ndërlidh me piken e 15- Njoftim rreth shkëputjes së Kontratës së shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të Komunës së Drenasit, unë nuk e di se si ka pas mundësi me ardh në kuvend deri sa ajo është në kontest gjyqësor, pala e ka fitu shkallen e parë tani ka kalu në shkallen e dytë. Kjo pikë e rendit të ditës ishte si njoftim mirëpo derisa ishte vetëm njoftim si e hodhe në votim ketë pikë të rendit të ditës, kërkoj sqarim?

**Labinot Halilaj,** kuvendit nuk ia ka shkëput kontratën votimi nuk ka qenë i domosdoshëm për me u votua, njoftimet dhe raportet nuk votohen.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari,** kërkoj ndjesë për këtë gabim për hedhje në votim të pikës se 15 të rendit të ditës sepse kjo u dashtë të kaloj vetëm si njoftim.

**Beqir Kiqina,** kërkoj një sqarim nga Drejtori i Arsimit lidhur me grevën në arsim të cilat janë duke u mbajt në nivel vendi nga SBASHK-u po ashtu edhe ne nivel lokal, kërkoj nga drejtori arsimit një sqarim.

**Mehedin Salihu,** po e ngarkoni rendin e ditës me shumë pika, kërkoj që ne seancat e radhës te kemi pika për rendin e ditës më pak. Kuvendi i kaluar sipas rregullores i ka ngarkuar disa biznese shumë padrejtë, i ka ngarkuar me takse të lartë nuk i ka ngarkuar njëjtë, po ashtu tarifat e komunës dallojnë varësisht prej viteve, vendimi është i njëjtë, shumë qytete në Kosovë taksa për biznese nuk kanë hiç, kërkoj një sqarim se ku po bazohen dhe si po bazohen ne vendosjen e taksave.

**Egzona Tërdeci,** pyeti Drejtorin e Arsimit derisa ne po flasim në Prishtinë është duke u mbajt protestë me rastin e fundit që ka ndodh me dhunim e një vajze 11 vjeçare, unë e kuptoj

që nuk është përgjegjësi tek niveli komunal, a keni mëndu ndonjë strategji për edukim apo vetëdijesim rreth edukatës seksuale apo ngacmimeve seksuale për të rinjtë në shkolla.

**Hamit Haxhiu,** çka ka ndodh me rrugën "Fatime Hetemi" nuk është punu asgjë edhe pse është afër qendrës se qytetit.

**Drejtori i Arsimit Muhamet Gjoka,** sa i përket grevës e kemi një paralajmërim nga SBASHK-u, ne si drejtori e arsimit jemi për me fillu procesi mësimor mirëpo njëkohësisht e respektojmë edhe të drejtën e mësimdhënësve por edhe stafit tjetër mbështetës për grevë. Ne si Drejtori e Arsimit në kuadër të strategjisë për rritjen e sigurisë në shkolla kemi paraparë edhe ligjërata vetedijesuese se bashku me policinë e Kosovës edhe për ngacmime seksuale kemi projekte që vetëm janë duke u realizuar që i mbajt si sanksione informuese përmes organizatave, ne fillim të muajit tetor me një organizate kemi me mbajte ligjërata vetëdijesuese lidhur me ketë dukuri shqetësuese lidhur me shoqërinë tonë por edhe për sistemin arsimor.

**Drejtori i Financave, Shyqeri Bublaku,** sa i përket rregulloren për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba, e cila hartohet në Kuvendin Komunal ju jeni ata që i aprovoni ato taksa deh ju jeni ata që i jepni sugjerimet tuaja, Kuvendi Komunal gjegjësisht Komuna e Drenasit ka të drejte të bëjë ngarkesa sepse ne nuk e kemi buxhetin e komunave të tjera si ajo e Prishtinës dhe nuk i kemi pasuritë e tyre të cilat realizojnë të hyra.

**Mehedin Salihu,** ngarkesa me takse komunale nder vite po dallon a është fjala që e ka ndryshu kuvendi komunal vendimin, edhe ekziston mundësia që bizneset me u lirua edhe këtë vit nga taksa komunale.

**Drejtori i Financave, Shyqeri Bublaku,** vitin 2019 ka qene tjetër rregullore 2020 është aprovua tjetër rregullore ne vitin 2021 tjetër, d.m.th. për ketë arsye taksa është ndryshe.

**Valentina Leku,** pyeti: me dt 26 maj të këtij viti janë mbajtur garat në volejboll në nivel vendi dhe SHFMU "Hasan Prishtina" në fshatin Llapushnik i komunës tonë i sjelli vendin e parë, pse nuk u nda se paku një mirënjohje nga komuna jonë për këta nxënës?

**Drejtoresha për Kulturë Rini dhe Sport Laureta Thaqi,** ne kur kemi gara dhe që organizojmë në nivel komunal në fusha të ndryshme sportive ndajmë çmime çdo here ndërsa për shkollën në fjalë nuk është se kemi pranuar ndonjë njoftim zyrtar që shkolla ka marrë pjese në atë garë dhe me na prezantua kush ka qenë ekipi fitues, për ndryshe për çdo garë e kemi mbajte janë ndarë mirënjohje, çmime.

**Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur seancën, seanca përfundoj rreth orës 12:55 min.**

*Me gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit të datës 31.08.2022 mund të ndiqni në ueb faqen zyrtare të komunës, rrjetin social të Fecebook-ut dhe në kanalin YouTube.*

Procesmbajtëse: Liridona Fejza-Ajazi ________ Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Erlona Gashi ________ Milaim Hajdari

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY

| Pranuar | 21/09 2022 | | |
|---|---|---|---|
| Nj. Org. | Numër | Shtojca | Vlera |
| 02- | 052/01-4886 | 0 | |

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosova**
**Komuna Drenasit**
**Municipality Drenas**
**Kuvendi Komunal**

# Raporti nga procesi i organizimit të dëgjimeve buxhetore për dëgjime publike për listën e projekteve Kapitale për Buxhetin e vitit 2023 dhe projeksioneve për vitet 2024-2025.

Me datë :**01.09.2022,** është publikuar njoftimi për organizimin e dëgjimit publik për dëgjime publike për listën e projekteve Kapitale për Buxhetin e vitit 2023 dhe projeksioneve për vitet 2024-2025. Njoftimin e publikua në ueb faqe mund të gjeni në këtë vegëz: https://kk.rks-gov.net/gllogoc/news/ftese-per-degjime-publike-per-listen-e-projekteve-kapitale-per-buxhetin-e-vitit-2023-dhe-projeksioneve-per-vitet-2024-2025/

Rikujtimet e publikuar në ueb faqe:

Me datë: **07.09.2022** https://kk.rks-gov.net/gllogoc/news/fillon-cikli-i-degjimeve-publike-per-projektet-kapitale-te-buxhetit-2023-2025/

Me datë: **07.09.2022** https://kk.rks-gov.net/gllogoc/news/fillon-cikli-i-degjimeve-publike-per-projektet-kapitale-te-buxhetit-2023-2025/

Me datë: **08.09.2022** https://kk.rks-gov.net/gllogoc/news/vazhdojne-degjimet-buxhetore-per-listen-e-projekteve-kapitale-per-vitet-2023-2025/

Njoftimi për organizimin e dëgjimeve publike për listën e projekteve kapitale për buxhetin e vitit 2023 dhe projeksioneve për vitet 2024-2025 u bë me dt: 01.09.2022 në ueb faqen e komunës së Drenasit, në këtë vegës:

https://kk.rks-gov.net/gllogoc/news/ftese-per-degjime-publike-per-listen-e-projekteve-kapitale-per-buxhetin-e-vitit-2023-dhe-projeksioneve-per-vitet-2024-2025/

Me qellim të rritjes së nivelit të transparenes e llogaridhenies dhe për t'i mbajtur sa më të informuar banoret e Komunës së Drenasit, rreth orarit dhe vendit të mbajtjes së degjimeve publike me qytetar janë berë me kohë planifikimet dhe është publikuar me

kohë kalendari i oranizimit të degjimeve publike në ueb faqen zyrtare të komunës si dhe në rrjetin social facebook, njoftimi në këtë vegëz:

https://kk.rks-gov.net/gllogoc/news/tese-per-degjime-publike-per-listen-e-projekteve-kapitale-per-buxhetin-e-vitit-2023-dhe-projeksioneve-per-vitet-2024-2025/

Njoftimet përveç që janë publikuar në ueb faqen e Komunës së Drenasit në platformen për Konsultime Publike, në rrjetin social Facebook, njoftimet u janë derguar edhe kryetareve të keshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane përmes rrjeteve sociale Viber dhe WhatsApp.

Komuna e Drenasit, përkatësisht Kuvendi Komunal dhe Komitetit për Politikë dhe Financa në bashkëpunim me Ekzekutivin e Komunës, kanë filluar mbajtjen e dëgjimeve buxhetore me qytetarë për të diskutuar lidhur me listën e Projektet Kapitale për periudhën 2023-2025. Dëgjimet buxhetore janë mbajtur sipas orarit të publikuar në ueb faqe dhe në rrjetin social Facebook (shih linqet).

Këto Dëgjime Buxhetore për Projekte Kapitale janë organizuar nga Zyra e Kuvendit të Komunës së Drenasit.

Të gjithë të pranishmit në dëgjimet buxhetore janë pajisur me materialet e nevojshme për të diskutuar. Ata para vetës kanë pasur draft-listën e projekteve kapitale si dhe draft-buxhetin për vitet 2023-2025 dhe pasi kanë paraqitur kërkesat e tyre kanë marrë përgjigje për kërkesat e parashtruara.

Ndryshe, buxheti i përgjithshëm i Komunës për vitin 2023 është 18.156.892.00 euro, ndërsa nga kjo shumë për investime kapitale janë planifikuar 6.335.649.00 euro apo 34.89%.
Takimet për Listën e projekteve kapitale do të zhvillohen më këtë rend dite.

1. Lista e projekteve kapitale për vitet 2023-2025,
2. Prioritete tuaja.

Të pranishmit kanë paraqitur kërkesat dhe nevojat e tyre për të cilat kanë kërkuar të futen si Projektet Kapitale 2023- 2025.

Bashkangjitur në këtë raport janë: Njoftimi për organizimin e konsultimit publik, lista e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në konsultim, lista e zyrtarëve pjesëmarrës në konsultim publik dhe gjatë konsultimit u është shpërndarë edhe qytetarëve të pranishëm në konsultim. Njoftimet që janë mbajtur takimet janë të publikuara në ueb faqen e komunës së Drenasit si dhe në rrjetin social Facebook. Procesverbalet e gjitha takimeve që janë mbajtur dëgjimet publike me qytetar në Komunën e Drenasit, se bashku me kërkesat e qytetareve.

Hyrje

| 980 | Digjitalizimi Ishkollave (platforma per digjitalizim dhe rrjet I mbrendeshem internet | | | | 60,000.00 | 60,000.00 | 60,000.00 | **180,000.00** | |
| 980 | Inventarizimi I shkollave ne Drenas | | | - | 43,000.00 | 50,000.00 | 75,000.00 | 168,000.00 | 0 |
| 980 | Furnizimi I shkollave me paisje të TIK-ut | | | - | 60,000.00 | 60,000.00 | 80,000.00 | 200,000.00 | 0 |
| 980 | Ndertimi infrastruktures percjellse dhe furnizimi me paisje per kabinet kimi,fizikë biologji | | | - | 50,000.00 | 50,000.00 | 50,000.00 | 150,000.00 | 0 |
| 980 | Ndertim I parkingjeve të shkollave dhe pllatove | | | | 30,000.00 | 10,000.00 | 10,000.00 | 50,000.00 | |
| 980 | Ndertimi I fushave te jashtme sportive dhe rrethoja te fushave | | | | 30,000.00 | 20,000.00 | 10,000.00 | 60,000.00 | |
| 980 | Kendi per lojra dhe rekracion | | | | 40,000.00 | 40,000.00 | 50,000.00 | | |
| 980 | Renovimi I shkollave objekteve shkollore ,nyje sanitare dhe ngjyrosje dhe suvatim | | | - | 78,000.00 | | 60,000.00 | 138,000.00 | 0 |
| 980 | Riparimi I nxemjeve qendrore | | | - | 14,000.00 | 10,000.00 | 10,000.00 | 34,000.00 | 0 |
| | | | - | - | **405,000.00** | **300,000.00** | **405,000.00** | **1,110,000.00** | **0** |
| | **Totali - Arsim dhe Shkencë** | | - | | **405,000.00** | **300,000.00** | **405,000.00** | **1,110,000.00** | **0** |
| | **Totali** | | - | | **6,041,095.00** | **7,158,142.00** | **7,942,758.00** | **21,141,995.00** | **0** |

Drenas-Gllogoc,me 31.08.2022

Kryesuesi I Kuvendit

Milaim Hajdari

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
**Komuna e Drenasit**
Zyra e Kryetarit

**01 Nr** 020/64- 47822 **dt.** 13/09 **2022**

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h)të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit te Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 18 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të rregullt të mbajtur më ____________2022 të aprovoi këtë:

# PROPOZIM VENDIM

Për formimin e Komisionit të Ankesave i cili do të shqyrtoj ankesat e palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës

## Neni 1

Më këtë Propozim Vendim i propozohet Kuvendit të Komunës formimi i komisionit të Ankesave i cili do të shqyrtoj ankesat e palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, në përbërje prej pesë (5) anëtarëve, të cilin Komision e përbejnë dy (2) anëtar nga Ekzekutivi i Komunës, të cilët i propozon Kryetari i Komunës, dy (2) anëtar nga Kuvendi i Komunës, nga subjektet e ndryshme të përfaqësuar në Kuvend dhe një (1) anëtar nga sektori jo qeveritar, i cili propozohet nga sektori jo qeveritar lokal, si vijon:

1. ____________________ anëtare nga ekzekutivi,
2. ____________________ anëtar nga ekzekutivi,
3. ____________________ anëtar nga kuvendi,
4. ____________________ anëtar nga kuvendi dhe
5. ____________________ anëtar nga sektori jo qeveritar.

## Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit të Ankesave është: të shqyrtoj ankesat e palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim, duke u bazuar në Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

**Neni 3**

Pala e pa kënaqur nga procesi i vlerësimit final të ofertave nga Komisioni për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së Paluajtshme të Komunës , ka të drejtë të paraqes ankesë brenda shtatë (7) ditëve kalendarike në Komisionin e Ankesave, i cili shqyrtoj ankesat e palëve në procedurën e dhënies se pronës se paluajtshme në shfrytëzim.

**Neni 4**

Mandati i komisionit të ankesave është dy (2) vjeçar brenda mandatit të Kuvendit të Komunës.

**Neni 5**

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.

Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

**Arsyetimi**

Komuna e Drenasit, respektivisht ekzekutivi i saj duke u bazuar ne ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës i propozon Kuvendit të Komunës së Drenasit formimin e komisionit të ankesave, i cili do të shqyrtojë ankesat e palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës.

E gjithë kjo kur kemi parasysh vendimin Nr.02-463-38614, të datës 27.07.2022 për miratimin paraprak të vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të komunës së Gllogocit në shfrytëzim afatgjatë, konfirmimit i ligjshmërisë Nr. 020-654/10, i datës 16.08.2022 së vendimit 02-463-38614, si dhe vendimin Nr.02-020/04-46339, të datës 31.08.2022 për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Me respekt!

Në bazë të nenit 5.2 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ligjin nr.04/L-111 për ndryshim plotësimin e ligjit nr.03/L-87 për Ndërmarrjet Publike, dhe nenit 11 ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040 ,si dhe nenit 72 pika 72.1 nën (h) të Statutit të Komunës së Gllogocit I dt.16.09.2008, kryetari komunës bijën këtë:

PROPOZIM-VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONERVE PËR NPL STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A–GLLOGOC

Neni I

Më këtë Propozim-Vendim formohet Komisioni Komunal të Aksionareve për Ndërmarrjen Publike Lokale Stacioni I Autobusëve SH.A-Gllogoc në përbërje prej:

I.1. Kuvendit të Komunës dy anëtarë: 1.______________

2.______________

I.2. Ekzekutivi i Komunës një anëtarë: 1.______________

Neni II

Komisioni Komunal i Aksionareve nga pika I e këtij vendimi obligohet të ushtroj të drejtat e aksionarit në përputhje me ligjin nr.03/L-087për Ndërmarrjet publike, Ligjin nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.03/L-087 për ndërmarrjet publike Nr.03/L-87 dhe ligjin nr.06/L-16 për shoqëritë tregtare.

Neni III

Mandati i anëtareve të komisionit komunal të aksionareve, të ndërmarrjes publike lokale Stacioni i Autobusëve SH.A- Gllogoc, përfundon me përfundimin e mandatit aktual të anëtareve të Kuvendit të Komunës, apo me ndonjë vendim tjetër të Kuvendit të Komunës.

Neni IV

Vendimi hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij dhe pas miratimit nga Kuvendi Komunal dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja.

Kryetari i Komunës

______________

Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Mbështetur në ligjin nr.03/L-087 për ndërmarrjet publike nenit 5 paragrafi 2 rregullon-Kur një komunë është aksionar në një NP Lokale, te drejtat e saj të aksionarit do të ushtrohet nga një Komision Komunal i Aksionareve i cili përbëhet nga (1) një anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe (2) anëtar tjerë të emëruar nga Kuvendi Komunal. Për këtë qëllim, komisioni komunal i aksionareve ka të drejtë të veprojë në emër të Komunës përkatëse dhe duhet të veprojë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, prandaj kërkojmë aprovimin për formimin e këtij komisioni nga Kuvendi i Komunës së Drenasit.

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova - Republic of Kosovo
**Komuna e Drenasit**
**Zyra e Kryetarit**
**01Nr.**-030/01-48007 **dt.** 14.09. **2022**

Në vështrim të nenit 58, paragrafi 1, nënparagrafi h të Ligjit Vetëqeverisjes Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit te Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë *të* nenit 12 dhe 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, neni 8 parag. 1.10 të Udhëzimit Administrativ (MPB) Nr. 01/2018 për regjistrimin e mjeteve, rekomandimet e Auditorit me Nr. 01-052/01-20086, të dt. 10.05.2022, Kuvendi i Komunës së Drenasit, të aprovoj këtë:

**PROPOZIM V E N D I M**

**Neni 1**

Me këtë propozim vendim, kërkohet që automjetet zyrtare të QKMF "Dr. Hafir Shala" Drenas, si dhe automjetet e Qendrës për Punë Sociale-Drenas, të kalojnë në pronësi të Komunës së Drenasit.

**Neni 2**

Përgjegjëse për menaxhimin e automjeteve të përfshira në listen e këtij propozim vendimi do të jetë Komuna e Drenasit, përkatësishtë njësia menaxhuese përkatëse.

QKMF

| | **Emërtimi** | **Viti** | **Dt. E regj.të p** | **Nr. I regj.(tg)** | **Gjendja teknike** |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Autoamb. Op. Viv. e re | 2011 | 2011 | 01-129-EI | Funksionale |
| 2 | Tojota - me rimorkio ngark. Ma | 1999 | 15,05,2001 | 01-221-CR | Funksionale |
| 3 | KIA - QKMF | 2012 | 01.07.2012 | 01-874-EI | Funksionale |
| 4 | Autoambulanca Pegueot | 2012 | 20.12.2012 | 01-326-ES | Funksionale |
| 5 | Autoambulanca Pegueot | 2013 | 2013 | 01-345-GI | Funksionale |
| 6 | Autoambulanca Pegueot | 2015 | 08.09.2015 | 01-460-IC | Funksionale |
| 7 | Renault Autoamb. | 2000 | 20.03.2019 | 01-211-JT | Funksionale |
| 8 | Mercedes Autoamb. | 2000 | 20.03.2019 | 01-513-KM | Defekt |
| 9 | VW - Passat Veture | 2007 | 20.03.2019 | 01-659-MI | Funksionale |
| 10 | Mercedes - Norvegji | 2011 | 12.07.2019 | 01-587-MQ | Funksionale |
| 11 | Peugeot 207 | 2011 | 01.01.2011 | 01-969-IN | Funksionale |
| 12 | VW-Transporter | 2003 | 01.01.2003 | 01-976-FN | Funksionale |

QPS

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Mitsubish | SH.SH. | 01.01.2012 | 01-947-ES | Funksionale |
| 2 | KIA -QPS | 2012 | 01.07.2012 | 01-877-EI | Funksionale |

Automjetet jo funksionale te çregjistruara

| | QKMF | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Fiat dukato | 1987 | | 01-276-BP | Jo funksionale |
| 2 | LDV Convoy | 2002 | 2008 | 578-ks-035 | Jo funksionale |
| 3 | Autoamb. - Savana GMS | 1998 | 30,07,2001 | 327-KS-739 | Jo funksionale |
| 4 | Kombi-VW | 2005 | 15,07,2005 | QKMF | Jo funksionale |
| 5 | Autoamb.-Opell Vivaro | 2005 | 15,07,2005 | 01-443-AF | Jasht funks |

| | QPS | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 12 | Frontera - QPS | 1999 | 2002 | 01-312-DT | Jo funksionale |
| 13 | Niva- QPS | 1999 | 2000 | 01-311-DT | Jo funksionale |

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale (QKMF dhe QPS).

**Neni 4**

Ky vendim hynë në fuqi nga dita e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës dhe pas vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.

**Kryetari Komunës:**
**Ramiz Lladrovci**

## ARSYETIM

Duke u bazuar në Raportin mbi Auditimin e kryer me temën "Menaxhimi me Automjetet e Komunës" me Nr. protokoli 01-052/01-20086, të dt. 10.05.2022, përkatësishtë rekomandimet e dala nga ky Auditim, nenin 8, paragrafi 1.10. të Udhëzimit Administrativ, si dhe kompetencave të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Drenasit, Kryetari Komunës vie me këtë propozim vendim që të gjitha Automjetet e QKMF "Dr. Hafir Shala" Drenas, si dhe automjetet e Qendrës për Punë Sociale-Drenas, të kalojnë në pronësi të Komunës së Drenasit, në mënyrë të njejtat të regjistrohen si automjete zyrtare, sipas rekomandimeve të auditorit, lista e të cilave është pjesë e këtij propozim vendimi.
Pas miratimit të këtij propozim vendimi në Kuvendin Komunal, si dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së, kompetente për të menaxhuar me këto automjete do të jetë Komuna e Drenasit, përkatësishtë njësia menaxhuese përkatëse.

Ky propozim drejtohet duke pasur parasysh legjislacionin në fuqi, s dhe rekomandimet e lartëcekura.

**REPUBLIKA E KOSOVËS**

Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit

01 Nr. 400/01-48164 Dt. 15.09.2022

**PËR**: Milaim Hajdari, Kryesues i Asamblesë Komunale në Drenas

**Nga**: Ramiz Lladrovci Kryetar ____________________

**Lënda: Draft-Raporti i progresit për Implementimin e rekomandimeve të ZKA-së, për vitin 2021**

| Çështja | E gjetura | Rekomandimi | Veprimet e ndërmarra dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatim të rekomandimit | Statusi I rekomandimit(I zbatuar,pjesërisht I zbatuar ose I pa zbatuar) | Sfidat e hasura në zbatimin e rekomandimit. |
|---|---|---|---|---|---|
| Çështja A1- | **Pagesat përmes vendimeve gjyqësore/përmbarimore** Neni 39 i LMFPP, përcakton ZKF-në e organizatës buxhetore përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallrat dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore. Ndërsa, sipas nenit 40, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhrit të prerë nga gjykata/përmbaruesi. Shuma e pagesave direkte nga Thesari, në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbarimore ishte 595,988€. Prej tyre 148,176€ ishin shpenzime të interesit dhe | Kryetari duhet të sigurojë planifikimin e drejtë të buxhetit duke forcuar disiplinën financiare që procesi i realizimit të pagesave të bëhet brenda planifikimeve buxhetore dhe afateve kohore të përcaktuara | Nenprogramet,perkatesisht menexheret e kontratave kanë rritur vigjilencen për planifikim më të mire të afateve të mbylljes së kontratave duke I harmonizuar autorizimet e punimeve komform buxhetit/vitit fiscal. | I zbatuar pjesërisht | Ne eleminimin e pagesave me urdher permbarimore te cilat jane pasoje e derivuar nga kontratat kolektive sektoriale, jemi te sfiduar per arsye qe ne si OB nuk mundemi ti planifikojme ne buxhet. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | procedurave të gjykatës/përmbarimit. Këto mjete janë shpenzuar nga:<br>• kategoria e pagave dhe mëditjeve në vlerë 499,027;<br>• investimet kapitale në vlerë 76,903€; dhe • kategoria e mallrave dhe shërbimeve në vlerë 20,058€. Sipas komunës,kjo ka ndodh si rezultat i obligimeve të dala nga kontrata kolektive për pagesën e shujtave dhe shpenzimeve të transport në sektorin e arsimin, pagesën e pagave jubilare dhe vonesave në pagesën e faturave. | | | | |
| **Çështja A2** | **Angazhimi i stafit për punë dhe detyra specifike pa procedura të prokurimi**<br>Sipas Ligjit Nr. 06/L-0114 për zyrtarët, përkatësisht nenit 84, përcakton se "Marrëveshjet për shërbime të veçanta, sipas paragrafit 4 të nenit 12 të Ligjit të Shërbimit Civil nr. 03/L-149 të Republikës së Kosovës, të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme deri në afatin e përcaktuar në ato | Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta. Po ashtu, menaxhmenti duhet të përkujdeset që angazhimet për pozitat e rregullta të zhvillohen përmes | Në procesin e rekrutimit të stafit I'u është kushtuar më shumë kujdes respektimit të kriterve në procedure rekrutese të cilat janë të parapara me ligj. | I zbatuar | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | marrëveshje në pajtim me dispozitat e lartcekura. Pas kësaj periudhe, marrëveshjet për shërbimet e veçanta lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik." Komuna ka angazhuar gjashtë zyrtarë për punë dhe detyra specifike për të cilët nuk ka udhëhequr procedurat e prokurimit. Angazhimet e tyre janë realizuar me procedurë të thjeshtëzuar duke nënshkruar kontrata të cilat ju referoheshin ligjit të punës përkundër që të njëjtit ishin angazhuar në drejtorinë e kulturës si zyrtarë të stadiumit sintetik (shërbyes civil). Kohëzgjatja dhe angazhimi i zyrtarëve ishte për një periudhë prej 120 ditë. Sipas zyrtarëve komunal angazhimi i stafit pa procedura ka ndodhur për shkak mungesës së njohurive për procedurat ligjore si dhe në mungesë të buxhetit nuk është lejuar plotësimi i pozitave me punëtorë të rregullt. | procesit të rregullt të rekrutimit. | | | |
| **Çështja A3** | **Mangësi në procedimin e pagesave** | Kryetari të sigurojë se respektohen hapat | Komuna ka ndermarr të gjitha masat qe mos të | I zbatuar | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Rregulla financiare Nr.01/2013 përcakton që fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, më pas zotimi i mjeteve, të procedohet urdhër-blerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa. Në pesë[4] raste, faturat në vlerë 162,133€ së bashku me situacionin mbështetës ishin pranuar nga komuna para datës së kërkesës për zotim të mjeteve dhe kërkesës për mallra dhe shërbime. Shkak i kësaj ishte vendimi i thesarit për anulimin e disa pagesave të proceduara në fund të vitit 2020, si pasojë e mungesës së mjeteve si dhe mungesa e komunikimit në mes njësisë kërkuese, zyrtarit për pranimin e faturave dhe zyrtarëve të pranimit të punëve/mallrave. | e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerje dhe në fund të pranohet malli/shërbimi dhe të kryhet pagesa. | kemi raste të tilla duke zbatuar procedurat, dhe rregulloret, dhe udhëzimet administrative të aprovuara nga MFPT. | | |
| **Çështja A4** | **Mos pagesa e faturave brenda afatit ligjor** Sipas nenit 39.1 të Ligjit nr. 03 /L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, kërkohet që | Kryetari duhet të sigurojë planifikim të buxhetit adekuat, si dhe inicimi i procedurave të shpenzimeve të | Komuna po vazhdon me angazhim maksimal që të gjitha faturat të paguhen brenda afatit të parapar ligjor. | I zbatuar. | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | secila faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë të mallrave dhe shërbimeve të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas marrjes së faturës. Në pesë[5] raste, faturat në vlerë totale 216,945€ nuk ishin ekzekutuar brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, vonesat kanë tejkaluar afatin deri 218 ditë kalendarike. Shkak i mos pagesës me kohë të detyrimeve është planifikim jo i mirë i buxhetit dhe inicimi i proceduarve të shpenzimeve pa mjete në dispozicion. | realizohet vetëm kur mjetet janë në dispozicion me qëllim të kryerjes së gjitha detyrimeve ndaj operatorëve ekonomik. | | | |
| **Çështja B1** | **Mos respektim i kritereve gjatë vlerësimit të aplikacioneve** Sipas thirrjes publike nr. 400/01-29622 të dt. 02.07.2020 për ofrimin e mbështetjes financiare për fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, ishte kërkuar kriteri për aplikim se "OJQ-ja aplikuese duhet të paraqesë dëshmi se gjatë një viti është marrë me organizimin e ngjarjeve kulturore, rinore ose | Kryetari, duhet të sigurojë se subvencionet ndahen në përputhje me kriteret e vendosura në thirrje publike dhe të siguroj se Organizatat jo qeveritare të mos përfitojnë subvencione pa i plotësuar/pagatitur projektin dhe formularin e buxhetit. | Komuna, këtë vit ka pasur Subvencione dhe me kohë u janë dërguar në formë elektronike Rekomandimet e Auditorit për të gjithë anëtaret komisionit,njëherit nga kryesusi i komisionit kemi konfirmimin se janë zbatuar rekomandimet në plotësimin e aplikimit dhe plotësimin e formularit Buxhetor-2022. | I Zbatuar | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | sportive, si dhe nëse ka qenë përfituese e mjeteve financiare të ndara nga Komuna e Gllogocit, të njëjtat mjete i ka justifikuar duke paraqitur raportin financiar dhe narrativ ". Po ashtu, në thirrjen publike për aplikim, është kërkuar që të përgatitet projekti dhe formulari i buxhetit. Nga testimi i mostrave, kemi identifikuar se në tre raste, Organizata Jo Qeveritare (OJQ) në fushën e sportit, kanë përfituar subvencione pa paraqitur dëshmi se gjatë një viti është marrë me organizimin e ngjarjeve kulturore, rinore ose sportive. Po ashtu, nuk kanë paraqitur dëshminë nëse kanë qenë përfitues të mjeteve financiare të ndara nga Komuna e Gllogocit dhe të njëjtat mjete i ka justifikuar duke paraqitur raportin financiar dhe narrativ. Përveç mungesës së dëshmive, OJQ-të kishin dorëzuar projektin dhe formularin e buxhetit të pa plotësuar/përgatitur, ku në | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | projekt kishin paraqitur vetëm informatat e OJQ-së dhe në buxhet vetëm një shumë totale pa e ndarë në llojet e kostove. Kjo ka ndodh si pasojë e vlerësimit jo të duhur sipas kritereve të përcaktuara në thirrjen publike nga komisioni i vlerësimit. | | | | |
| **Çështja B2** | **Mungesa e projekteve ekzekutuese**<br>Neni 20 pika 10 i Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (UOPP) kërkon që "Specifikat teknike për kontratën e punës, duhet të përfshijnë një projekt ekzekutues si pjesë substanciale të veten". Ndërsa pika 13 "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet ti bashkëngjitet specifikave teknike të cilat janë pjesë e dosjes së tenderit". Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkangjitur përshkrimin e hollësishëm | Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me punë, të mos iniciohen procedurat pa u siguruar specifika të qarta sipas projektit ekzekutues të cilat do të ndikonin në eliminimin e vonesave dhe të kostove shtesë. | Drejtoria e Infrastruktures Publike, ka inicuar proceduarat e tenderimit te proejktit Hartimi I projekteve per nevoja te komunës e cila si procedur është kthyer ne rivlersim.<br>Hartimi i projekteve për nevoja të komunes eshte inicuar me këtë numer të protokolit 15-400/01-16616 të dates 15.04.2022. | I zbatuar pjesërisht | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | të projektit. Në tre raste për kontratat: Rregullimi i infrastrukturës trotuar dhe ndriçim publik në Komunën e Gllogocit (197,788€), Rehabilitimi dhe rikonstruimi i rrjetit të kanalizimit në Komunën e Gllogocit (144,750€) dhe Asfaltimi i rrugës në fshatrat Gllanasellë-Godancë (124,452€), komuna nuk kishte hartuar projekte ekzekutuese, por kishte iniciuar proceduarat e prokurimit duke përgatitur vetëm paramasën dhe parallogarinë. Shkaku i mungesës së projekteve ekzekutuese sipas zyrtarëve të komunës ishte mungesa e buxhetit për kontraktimin e një OE për hartimin e projekteve ekzekutive. | | | | |
| **Çështja A5** | **Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve** Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF "Mbi shpenzimin e parasë publike" shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin | Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet/kategoritë adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen | Menagjmenti I komunës po benë kujdesin e duhur dhe po zbatohen politikat dhe proceduart mbi shpenzimet e parasë publike sipas Udhëzimeve Administrative, dhe pagesat dhe regjistrimi I | I Zbatuar | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë. Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në kategoritë ekonomike jo adekuate në vlerë prej 13,243€, si në vijim: Nga kategoria për mallrat dhe shërbimet janë planifikuar dhe realizuar pagesa në vlerë 5,000€, të cilat për nga natyra i takojnë kategorisë për subvencione dhe transfere; dhe Nga kategoria për investime kapitale janë planifikuar dhe realizuar pagesa në vlerë 8,243€ të cilat për nga natyra i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve. Keqklasifikimi ka ndodh për shkak të planifikimit jo adekuat të shpenzimeve sipas kodeve ekonomike. | mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe të saktë sipas kodeve ekonomike adekuate. | shpenzimeve po bëhet sakt sipas kodeve ekonomike. | | |
| **Çështja A6** | **Mungesa e kontrolleve në përgatitjen e Draft Pasqyrave Financiare Vjetore**<br>Përgatitja e PFV-e duhet të bazohet sipas Standardeve | Kryetari duhet të sigurojë që përmes personave përgjegjës, gjatë hartimit të pasqyrave për vitin 2022, ti | Do merren masat që PVF të jenë në harmoni me standardet ndërkombëtare. | Nuk ka periudhë krahasuese. | Të sqarohen dilemat dhe të harmonizohen qendrimet mes institucioneve si Komunë, MFPT dhe ZKA |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik dhe Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme si dhe sipas Rregullores së MFTP nr.01/2017 për Raportimin Vjetor Financiar të Organizatës buxhetore. Komuna ka përgatitur dhe dërguar në Thesar PFV-të sipas afatit të paraparë deri me 30 janar. Megjithatë me rastin e rishikimit të PFV-e, nga ana e auditimit, janë vërejt disa çështje të cilat i kemi rekomanduar, Komunës për korigjim. Çështjet e identifikuara janë: Pasqyra 1, neni 13 - Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, Burimi i Fondeve –Pranimet, nuk është prezantuar Kthimi i Depozitave ne vlerë 76,170€. Pastaj kjo nuk është prezantuar edhe te Shfrytëzimi i Fondeve – Pagesat, te shënimi 7 pagesat tjera si Kthimi i depozitave. Pasqyra 1, neni 13 - Pasqyra e pranimeve | kushtohet vëmendje që mos të kenë gabime kontabël dhe administrative dhe të gjithë zërat në pasqyrat financiare të jenë drejtë dhe të sakta. | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | dhe pagesave në para të gatshme te burimi i fondeve- grantet e përcaktuara te donatorëve është prezantuar vlera për 11,000€, ndërsa shpenzimi i donacionit ishte në vlerë 531,620€. Pasqyra 2, neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit pjesa hyrja e paras në LLVTH shënimi Nr. 8 te hyrat tatimore buxheti final është prezantuar me vlerë 716,000€ ndërsa sipas Buxhetit është 495,700€. Pasqyra 2, neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit pjesa hyrja e paras në LLVTH shënimi nr. 9 të hyrat Jo tatimore buxheti final është prezantuar me vlerën 451,000€, sipas Buxhetit është 810,951€. Pasqyra 2, neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit të Hyrja e Paras tek të tjera, nuk është prezantuar Pranimi i Depozitave në vlerë 185,629€. Pasqyra 2, te Hyrja e parasë së gatshme shënimi Nr. 11 grantet e përcaktuara të donatorëve realizimi për vitin 2021 të hyrat nga | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | donacionet janë në vlerë prej 528,437, ndërsa në pasqyra është prezantuar në vlerë 11,000€. Me rekomandim të audtorve , PFV janë korrigjuar në afatin e paraparë. Kjo kishte ndodh për shkak të kontrolleve të brendshme jo të mjaftueshme dhe kujdesit të mangët të stafit përgjegjës në përgatitjen e PFV-ve. | | | | |
| **Çështja A7** | **Mangësi në menaxhimin e të dhënave nga tatimi në prone** Neni 11 paragrafi 1 i Ligjit me nr. 06/L-005 për Tatimin në pronën e paluajtshme - Zbritja për vendbanimin parësor, paraqet: "Personi fizik, i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në Komunë apo gjatë fazës së inspektimit, i lejohet zbritja prej pesëmbëdhjetë mijë (15,000€) nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit". Nga analiza e bazës së shënimeve të | Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në departamentin e tatimit në pronë, në mënyrë që të dhënat në sistemin Protax të jenë të harmonizuara me rregulloren e tatimit në pronën e paluajtshme të komunës dhe me ligjin e tatimit në prone. | Pase rekomandimit nga ZKA dhe rekomandimit nga DTP-MF ,ne kemi filluar ti verifikojme dhe identifikojme tatimpageusit 999 dhe kemi filluar verifikimin dhe vendosjen e numrave personal-valid, në menyr që të përllogaritet zbritja prej 15.000.00€ nga vlera e pronës për banim primarë. Sipas e-mailt nga zyrtaret e DPT te dates 04.02.2022 për tatimpaguesit që kanë objek rezidencial për banim parësor ne 2 ose më shumë komuna rastet të zgjidhen sipas ligjit të tatimit në Pronë e palujtshme nr.06/L- | I zbatuar pjesërisht | Të rastet ku tatimpaguesi është i vdekur, tatimpaguesi I cili nuk banon në teritorrin e kosovës dhe nuk I kanë të dhënat e sakta,nuk kemi mundur ti zabtojmë këto kritere për të ardhur deri te zbritja në vlerë prej 15.000.00€.<br>Sipas listes se derguar nga DTP kemi verifikuar dhe kemi kerkuar ndihmen e ZGJC për furnizim me nr. Personal të obliguesve tatimor.<br>Sfid e kemi personat të cilet janë të vdekur dhe personat jasht vendit . |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Protax-it kemi konstatuar se në 84 raste (prona/objekte të tatim-paguesve), ju ishte bërë zbritja e parregullt e vendbanimit parësor prej 15,000€, si rezultat, për arsye të nën-faturimit të hyrat janë më të vogla për 1,890€. Po ashtu, nga analiza e bazës së shënimeve Protax, si rezultat i mos zbritjes së vendbanimit parësor prej: 15,000€, Komuna ka mbi-faturuar 52 tatimpagues në vlerë prej 1,170€. Për rastin e parë shkaku është si rezultat i mos deklarimit të vendbanimit parësor nga ana e tatimpaguesve dhe mos vlerësimit (ri anketimit) gjatë fazës së inspektimit nga ana e anketuesve në teren. Derisa për rastin e mbi faturimit, shkaku është tek mungesa e kontrollit dhe vëmendjes në përditësimin e të dhënave të tatim paguesve. | | 005,qdo tatim pagues ka vetem një banim primar. Në këtë listë gjithashtu gjendet numra personal të tatimpaguesve që janë gabim dhe të cilet mund të korigjohen gjatë këtij viti deri më 30 nëntor,por që të njëjtit do të përfitojnë zbritje për vendbanim parësor në vitin 2023. Gjithëashtu listen e kemi publikuar ne Web faqen e komunes,ku kërkohet që se cili tatimpagues të deklarojë për vendbanim primar në menyrë që te perfitojë nga kjo zbritje. | | |
| **Çështja C1** | **Vonesa në deponimin e parasë së gatshme në llogarinë bankare** | Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në | Deponimi I mjeteve nga Arka e komunes janë duke u dorëzuar qdo ditë ne Bank pas perfundimit të orarit te | I zbatuar. | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Neni 11 i Rregullës Financiare 03/2010 për të hyrat përcakton që paratë e grumbulluara nga Organizatat Buxhetore (OB) nga arkëtimet për shërbime në lartësi deri 10€, duhet në fund të ditës të depozitohen në llogarinë bankare. Në dy raste kemi evidentuar se paratë e arkëtuara për shërbime kadastrale dhe në administratë, nuk ishin depozituar me kohë në arkë, rrjedhimisht në, bankë. Vonesat ishin nga dy ditë deri katër ditë, ndonëse vlerat monetare nuk ishin materiale. Përkatësisht: Të hyrat e arkëtuara nga taksat për ndërrimin e destinimit të tokës nga data 24.02.2021-26.02.2021 në vlerë 480.50€ ishin deponuar në bankë me datë 26.02.2021. Të hyrat e arkëtuara nga taksat për regjistrim të automjeteve nga data 08.07.2021-09.07.2021 në vlerë 876€ ishin deponuar në bankë me datë 12.07.2021. Kjo ka ndodhur | mënyrë që paratë e gatshme të grumbulluar të dorëzohen me kohë në arkë dhe të depozitohen në bankë në harmoni me kërkesat e rregullës financiare për të hyrat. | punës nga janari I këti viti deri me tani, nuk kemi pasur vonesa  në asnjë rast që deponimi është bërë me vonesë. | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | si shkak i kontrolleve të brendshme jo efikase përkatësisht rrethanave vështirësuese në organizimin e stafit. | | | | |
| **Çështja A8** | **Vonesa në përfundimin e punëve të kontraktuara** Rregulla dhe Udhëzuesi Operativ të Prokurimit Publik, pikat 61.6, 61.19 dhe 61.20 përcaktojnë se: "Menaxherët e kontratës janë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe duhet të sigurojnë se OE kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë. Secila kontratë publike ka të përcaktuar afatin kohor të implementimit. Në tre pagesa të testuara, kemi evidentuar vonesa deri në 41 ditë .Vonesat kanë të bëjnë me projektet si në vijim: • Kontrata "Ngjyrosja dhe suvatimi i objekteve shkollore faza II" në vlerë 15,310) e nënshkruar me datë 01.10.2021; • Kontrata "Ndërtimi i infrastrukturës Nekoc, Kizhnarekë" në vlerë 81,341€ e nënshkruar me | Kryetari duhet të siguroj që, përmes menaxherit të prokurimit, si dhe menaxherëve të kontratave, se realizimi i kontratave bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve dhe për vonesat e pa arsyetuara, të aplikohen masat e parapara në kontratë. | Te gjith menagjeret e kontratave në vazhdimësi po percjellin planin dinamik për realizimin e projektev në afatet e parapara. Vonesat eventuale gjatë realizimit të projekteve duhet të arsyetohen ose do aplikohen penalet. | I zbatuar pjeserishte | Në këtë vit jemi të sfiduar tej mase shkak I rritjes extreme të çmimeve e të cilat po ndikojn direkt në vazhdimin e punimeve të kontraktuara ne vitin 2021 dhe vazhdimi I tyre në këtë vit. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | datë 07.07.2021; dhe • Kontrata "Infrastruktura në Komoran I,II,II dhe IV, projekt dy vjeçar" në vlerë 143,614€ e nënshkruar me datë 22.10.2020. Duhet theksuar se në asnjërin prej këtyre rasteve nuk kishte kërkesë/aprovim për zgjatjen e afatit për realizimin e kontratave. Sipas zyrtarëve komunal, shkaku i vonesave në pune ishte pandemia COVID-19, megjithatë, vonesat janë reflektuar edhe nga mungesa e kontrolleve të brendshme. | | | | |
| **Çështja B3** | **Dobësi në menaxhimin e pasurisë**<br>Neni 6.3 i Rregullores nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare thotë se: Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria. Më tutje Neni 19.4.3 i Rregullores nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare: Përcakton se çdo fund vit duhet të bëhet krahasimi i | Kryetari, duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale. Po ashtu duhet siguruar se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare | Komuna ka ndermarr të gjitha masat dhe shuma prej: 2,648 € vetem është tanime e regjistruar me ketë nr. Të ID 84150.<br>Edhe për katër raste, te cilat kanë të bëjnë me furnizim të pajisjeve, në vlerë 13,706 € janë te regjistruar nga ana e drejtorisë së Arsimit dhe që është regjistruar ne E-pasuri Numri I faturës:1148/2022 dhe me Numer I fletëngarkimit:2757/2022. | I Zbatuar | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | gjendjes se inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare. Nga testimet e realizuara, kemi evidentuar se në një rast, pagesa e shpenzimeve kapitale për hartimin e projekteve zbatuese në vlerë 2,648€, nuk ishte regjistruar në SIMFK. Ndërsa në katër raste, te cilat kanë të bëjnë me furnizim të pajisjeve, në vlerë 13,706 €, nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria. Procesi i inventarizimit të pasurive jo financiare ishte kryer me vonesë, ku nuk ishte bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare para datës së përgatitjes së PFV-ve. Si rezultat, nuk dihet diferenca mes gjendjes se regjistrit të përgjithshëm dhe inventarizimit. Sipas zyrtarëve komunal, kjo gjendje ishte mungesa e një sistemi te komunikimit ndërmjet departamenteve, gjithashtu për shkak të njohurive lidhur me | në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat. | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive. | | | | |
| **Çështja B4** | **Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme**<br>Sipas nenit 16 të Rregullore MF- nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar, Organizatat buxhetore që mbledhin të hyra janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara e të pa arkëtuara. Arkëtimi i të hyrave duhet të bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në faturë për secilin lloj të të hyrave. Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e të arkëtueshmeve pasi që vazhdon rritja nëpër vite tek tatimi në pronë dhe tek qiraja nga objektet publike. Në krahasim me vitin paraprak rritja ishte rreth 29,199€.<br>Për licencat e biznesit sistemi të cilin e përdor komuna nuk gjeneron një regjistër të arkëtueshmeve në detaje për bizneset individuale vetëm si vlerë të përgjithshme (faturimet – | Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme në mënyrë të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e tyre, duke mos përjashtuar edhe masat juridike. Po ashtu të siguroj funksionimin e sistemit për licencat e biznesit që të gjeneroj raporte sipas informatave të nevojshme për komunën. | Në vazhdimësi jemi duke i respektuar afatet ligjore për procedurat përmbarimore.Jemi duke I aplikuar pezullimet e shërbimeve komunale, për mospagesë të borgjeve të vjetra, bazuar në rregulloren (QRK) NR. 07/2021 mbi pezullimin e sherbimeve komunale për mbledhjen e detyrimeve të papaguara të tatimit në pronë.<br>Për munges te inkasimit te borxheve mbi qerat ka ardhur për shkak se Ministria e Tregtisës e menaxhon parkun industrial (K.e Eperme),ku 70% emjeteve sipas memorandumit duhet ti barten K.Drenas.Këto mjete nuk janë paguar në Llogarin e K.Drenasit,ku për borxhin e pa paguar nga MTI i kemi derguar lendet ne Gjykatën kompetente (procedur permbarimore). | I Zbatuar pjesërisht. | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | pranimet). Po ashtu për arkëtimin e tyre komuna nuk ka ndërmarr asnjë veprim. Dobësitë e identifikuara lidhur me llogaritë e arkëtueshme janë për shkak të kontrolleve të brendshme jo efikase në menaxhimin përkatësisht arkëtimin e tyre, si dhe mos gjenerimi i regjistrit të arkëtueshmeve në detaje për licencat e biznesit ka ndodhur shkaku i mosfunksionimit të modulit të obligimeve në sistem. | | Ndërsa, sa i përket kërkesës për regjistër të Arketueshmeve ky sistem nuk na ofron një regjister të tillë, por gjendjen e secilit biznes për pagesat dhe borgjet apo obligimet mund të shihen në kartela financiare individuale, | | |